



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.27.09.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetari i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit dhe Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Dhënia në debar publik e Draft Rregullores “Programi trevjeçar për Banim në Komunën e Obiliqit
4. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për vitin 2023
5. Miratimi i buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që të ndryshohet dhe plotësohet rend i ditës, do të thotë në pikën e 6-të, të jetë propozim vendimi nr.1270 për shpallje me interes të përgjithshëm publik dhe në pikën e 7 të jetë propozim vendimi nr.1271 për shpallje me interes të përgjithshëm publik për objektet të cilat gjenden në zonën kadastrale në Obiliq.

Miratohet rendi i ditës me 20 vota për me ndryshimin dhe plotësimin e cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Linda Sadiku Krasniqi

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohen me 13 vota për, 4 vota kundër dhe 2 vota abstenim ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DSHMS-ja, për dhënien në debat publik të Draft Rregullores “Programi trevjeçar për Banim” në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Ne nuk kemi asgjë për të shtuar, por Draft Rregullorja në fjalë së pari le të delë në debat publik, pastaj kur vjen në Kuvend ne do ta jepim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ne si LVV, jemi subjekt social demokrat, që do të thotë se i përkrahim shtresat që kanë nevojë. Te kjo Draft Rregullore kemi vërejtje të shumta, kryesisht që kanë të bëjnë me ndryshimet demografike të Komunës tonë, por këto do ti dërgojmë me shkrim te drejtoresha në fjalë. Ne do të përpiqemi që të jepim kontributin tonë në debatin publik dhe po ashtu, edhe në Kuvend. Ne jemi për atë që kjo Draft Rregullore të shkoj në debat publik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Rregullores “Programi trevjeçar për Banim” në Komunën e Obiliqit.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për caktimin e normave tatimore për vitin 2023.

Zarife Behluli – Vendimi për caktimin e normave tatimore duhet vit pas viti, kështu që ne jemi obligativ, që përmes Kuvendit ta kemi vendimin për caktimin e normave tatimore. Ju njoftoj se normat tatimore sipas ligjit mbi tatimin në pronë janë në minimum më të ulëta që shkon prej njësisë bujqësore të parcelave deri te njësitë rezidenciale të objekteve, që nuk ka nivel më të ulët për norma tatimore. Njësitë komerciale të parcelave dhe njësitë komerciale të objekteve janë 0.25 %, ndërsa për njësitë industriale të parcelave dhe njësitë industriale të objekteve është 0.30 %, dhe këtu bëjnë pjesë Kompanitë siç është KEK-u. Unë nuk kisha me thënë që me i zvoglue normat tatimore sepse ne e kemi KEK-un, që na sjellë të hyra sipas kalkulimit të tatimit dikund rreth 400,000 €, brenda vitit. Llogaritja e tyre bëhet ashtu që vlera e parcelës që bëhet Departamenti i tatimit në pronë në bashkëpunim me Agjensionin kadastral të Kosovës, i cili Agjension bashkëpunon me Komunën e Obiliqit, i përcaktojnë vlerat sipas zonave psh një parcelë në sipërfaqe prej 975 m² shumëzohet me çmimin e zonës 28 €, pastaj vlera e parcelës është 27,300 €. Tani, këtë kur e shumëzohet me 0.15 % del një vlerë prej 40.95. Këtë e shpjegova sepse më keni bërë një pyetje kur ishim në Shqipëri dhe pata obligim me ua sqarue.

Enver Gashi – Ne jemi për aprovimin e këtij propozim vendimi.

Sami Ahmeti – Normat tatimore të prezentuara në këtë dokument janë të njehta me ato të viteve të kaluara respektivisht me vitin 2020 dhe 2021. Këtë të vitit 2021 e kemi miratuar por u shfuqizua për shkak të vonesës në miratim, prandaj drejtoresha mjaftonte të thonte se janë të ngjashme me ato të kaluara dhe nuk ka nevojë për ndryshime. Ne jemi për atë që ti aprovojmë këto norma tatimore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e aprovuan Vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2023.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja për miratimin e buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025.

Enver Gashi – Ne me këtë buxhet jemi duke u marrë veç qe 3 muaj ditë edhe si Drejtori e financave dhe si anëtarë të Kuvendit. Ne si grup parlamentar nuk kemi çka të shtojmë dhe jemi për atë që të aprovohet ky buxhet.

Sami Ahmeti – Ne kërkuam edhe në mbledhjen e KPF-së, që Ekzekutivi të na prezentoj buxhetin e specifikuar së paku për vitin 2023, por siç duket ai nuk ekziston. Keni bërë një buxhet copy paste të buxheteve paraprake, aty këtu me ulje dhe ngritje të shifrave, që nuk ka asgjë të specifikuar. Ne as qytetarët nuk e dijmë se çka do të bëhet aty, apo këtu. Në fakt, kjo është tendencë për të miratuar një buxhet me mjete të të cilit do të investohet selektivisht në lokalitete, ashtu siç paralogarisni ju për vota. Ne kuptojmë dhe jemi të vetëdijshëm për ligjin e Prokurimit, gjegjësisht OSHP-në dhe zvarritjet që bëhen atje, që shkaktojnë vonesa në investimet e parapara. Atyre, ju lirisht mundeni me iu prezentue formën qysh na keni prezentue neve, por ky dokument për neve është i rëndësisë së veçantë dhe duhet të na paraqitni të detajuar sepse jemi përfaqësues të qytetarëve dhe ata çdo ditë na pyesin se a është në projekt kjo rrugë, kjo urë, kjo shkollë, kjo ambullantë, apo edhe çerdhe. Ndërsa, ne çka të iu themi shkoni te drejtoresha, apo te Kryetari i Komunës dhe aty e bëni planin bashkë. Kjo formë e miratimit të buxhetit e shtron rrugën e pazareve me paratë e

taksapaguesve për aspekte elektorale. Të paktën, ne mendojmë kështu. Edhe buxheti i Republikës së Kosovës, kur miratohet specifikohet deri në detajin më të vogël. Në seancën e dt.29 qershor kur është miratuar ky projekt buxhet, ne patëm propozuar që për vitin 2023 dhe planifikimi për vitin 2024 dhe 2025 të përfshihen 5 propozimet tona, që i kemi bërë ne dhe janë për qytetarët që nuk duhet të shihen si të subjektit politik. Ashtu, ato ishin: vendosja e ashensorëve në banesat e qytetit, ndërtimi i parkingut të varrezat e qytetit, ndërtimi i çerdhes në Milloshevë, krijimi i infrastrukturës për kthimin e Qyqavicës në zonë turistike, ndërtimi i shtigjeve të biçikletave për fshatrat e afërta me qytetin që është Millosheva, Mazgiti i Epërm, i Poshtëm dhe Plemetini. Ne në këtë dokument të paraqitur nga ju nuk mund të shohim ndonjë përgjegje të propozimeve tona dhe ne përsëri insistojmë që propozimet tona të merren parasys, por në rast se nuk do të reflektoni ne jemi kundër miratimit të këtij buxheti për këtë dhe arsyet e cekura më lartë.

Ajet Berisha – Është një buxhet i planifikuar vetëm në vija që i parashehë Ministria, pa ndonjë specifikim i cili e vlen mundin për me u përkushtue me thënë se është planifikue kjo, ose nuk është planifikue kjo. Kryetari me Ekzekutiv iu ka mundësue me vendosë vetë për mënyrën se nga do të investoj, ose përmes linjave të subvencioneve, bashkëfinancimeve, apo diçka tjetër. Te subvencionet është interesantë te DSHPE-ja, lehen subvencione dikund rreth 300,000 €, për vit gjithë që unë nuk shohë se kjo Drejtori ka diçka për me subvencionue. Unë e kuptoj Drejtorinë e Arsimit, të shëndetësisë, por te DSHPE-ja, nuk shohë ose së paku kërkoj sqarim se çka ka me subvencionue kjo Drejtori. sepse detyrat që i ka nuk ka hapësirë për subvencionim. Pra, me mungesën e dëshirës për me na prezentue një buxhet më të specifikuar, vërtetë mungon edhe dëshira për me u përkushtue ne për këtë buxhet me dhënë ndonjë vlerësim, apo mendim. Është buxhet i juaj, i pozitës dhe konsultimet formale që pretendoni se i keni bërë vërtetë janë formale dhe ju e dini më mirë se ne, kështu që i keni numrat dhe mundeni me vendosë pa neve.

Zarife Behluli – Ne i kemi mbajtur debatet publike si për Kornizën e parë buxhetore, ashtu edhe për Qarkoren e dytë buxhetore dhe kush ka qenë prezentë i ka specifikue nevojat e veta. Buxheti bëhet për qytetarin, nuk bëhet as për Kryetarin e Komunës, as për drejtorë. Ne jemi për të mirën e qytetarit për rregullimin e infrastrukturës në të gjitha segmentet. Sipas Qarkores së dytë buxhetore, buxheti komunal për vitin 2023, i kemi paga dhe shtesa 4 milionë e 500,000 €, mallra dhe shërbime 1 milionë e 550,000 €, shpenzime komunale janë 380,000 €, subvencione dhe transfere një milionë, shpenzime kapitale 5 milionë e 491,229 €. Në mbledhjen e KPF-së, buxheti ka qenë ashtu qysh e the i nderuar, por nuk kemi arritë me i specifikue me rrugë, me kanalizime dhe për mbledhjen e Kuvendit kemi arritë ti specifikojmë investimet kapitale sipas rrugëve, që edhe Ministria e financave, ashtu i kërkon. Disa vërejtje për emërtimin e rrugëve i kam marrë kur ishim në takim me anëtarë të Kuvendit dhe me Ekzekutivin, që veç jemi duke i përmirësue.

Ajet Berisha – Unë e bëra një pyetje dhe nuk mora përgjegje se çka subvencionon DSHPE-ja.

Zarife Behluli – Përgjegjet se sa e di unë atëherë ke qenë me neve kur i kemi ndarë 300,000 €, për subvencionimin e rrymës, por ajo ende nuk ka ndodhë dhe ne kemi vazhdu me lënë atë vijë buxhetore, kështu që për vitet 2020, 2021 dhe 2022 pothuajse të gjitha mjetet kanë shkue për covid, eventualisht ndonjë ndihmë për rastet e rënda ndonjë ndërtim, ose për qira.

Ajet Berisha – Drejtoreshë 2, ose 3 vite me rend me ua kthye vendimin Ministria, për një diçka nuk është në rregull, nuk është e ligjshme dhe ju me vazhdu deri ne vitin 2025, me lënë linjë aty. Kjo është tendencë për me keqpërdorë, ose me i dërgue ku të doni ju vetë këto mjete sepse kjo më së paku është planifikim. Ju nga sot e dini se ato mjete nuk kanë me shkue për atë qëllim që ti po e thua sepse nuk ke të drejtë me subvencionue, me ligj është e përcaktuar se qysh do të lirohet rryma për qytetarët e Obiliqit. Ju a e keni në plan me ndryshue ligjin, a e keni në plan me inicue ndryshim të ligjit, që me ia dhënë këtë mundësi Komunës, apo veç sa për sy e faqe, apo për ndonjë lloj mashtrimi po e leni këtë pjesë.

Kryetari – Planifikimin buxhetor nuk e kemi bërë vetëm ne, por e kemi bërë bashkarisht me qytetarë dhe thirrjet kanë qenë për ata që kanë dashtë me marrë pjesë në debate. Ju e dini se ne disa herë e kemi procedue Rregulloren për subvencionimin e energjisë elektrike, por fatkeqësisht nuk ka kalue. Ne do të bëjmë përpjekje për atë edhe e kemi lënë si vijë buxhetore dhe për çdo ndryshim që ka ndodhë nga ajo vijë

ne gjithëherë kemi raportue. Prandaj, nuk ka mundësi për keqpërdorim sepse në raporte përshkruhen të gjitha shpenzimet se në cilat forma janë shpenzue.

Sami Ahmeti - Unë e falenderoj drejtoreshën që mori mundin me dalë deri në foltore dhe mos me thënë kurgjë. Realisht ato që neve na janë dërgue filloi më na lexue duke na treguar që e ka marrë me vete një buxhet qysh na e kemi kërkuar në KPF, por atë ne nuk e kemi, e keni vetëm ju. Pikërisht, kjo ka qenë pyetja dhe kërkesa jonë sepse anëtarët e Kuvendit duhet me pasë për me ditë se ku çka ka me u investee nga se janë përfaqësues të qytetarëve. Sido që të jetë ashtu qysh e tha parafolësi, ju i keni votat dhe mund të shkoni përpara. Sa i përket asaj se jeni marrë vesh nëpër debate publike shumë mirë , por unë e di se Kuvendi komunal është organi më i lartë dhe nuk duhet me vënë në pedestal debatin publik në raport me Kuvendin komunal. Ne kemi të drejtë me i dhënë propozimet tona, kemi të drejtë me i dhënë edhe vërejtjet tona dhe nuk ka nevojë me u marrë keq ato sepse në fund të fundit është për të mirën e qytetarëve, që i përfaqësojmë, që shumë shpesh janë të ngjajshëm a janë të këtij, apo të subjektit tjetër politik. Ndërsa, sa i përket Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike, që u bisedue nuk ishim pjesë e kësaj replike megjithatë, ajo qysh në fillim është ditë që është e jashtëligjshme dhe do të vazhdoj kështu të mbetet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 7 vota kundër e aprovuan Vendimin e Buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024-2025.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DPUKP-ja, për aprovimin e propozim vendimit me nr.1270, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Obiliq.

Enver Gashi – Ne e përkrahim këtë iniciativë.

Sami Ahmeti – Këto, zhvillimet me pronat publike si përgjithësi ne si grup i anëtarëve të LVV-së, për neve janë këto gjëra prapa të cilave dyshojmë se ka shumë keqpërdorime, e thashë dyshojmë. Po kërkohet që të shpallim zona me interes publik dhe nga përvoja shumica e këtyre të ashtuquajturave interese publike janë përdorë për interesa private e klanore. Ne edhe për këto 2 propozime do të abstenojmë.

Ajet Berisha – Një kërkesë e tillë është dashtë me ardhë me një sqarim që thotë shpallë zonë me interes të veçantë ndërsa, nuk ka asnjë propozim pse kjo është e veçantë. Në rast se është rrezikshmëria është diçka tjetër, por çka planifikon Komuna në këto pjesë vërtetë, kjo kishte me bë të veçantë, e jo pse dikush e parashë se është e veçantë, ose pse dikush nesër këtë pronë don me shpallë të veçantë e pasnesër e shpallë si zonë që duhet me ia dhënë dikujt. Në parim është vullneti i dikujt personal për me bë këtë punë pa ndonjë interes publik sepse ne nuk po e dijme, minimalisht nuk ka shpjegim për interes publik, kështu që ne jemi kundër këtyre 2 vendimeve, sepse nuk ka interes publik nëse, nuk ka sqarim publik. Sqarimi është i juaji, për veten tuaj dhe mbane për vete. Meqë, keni vota të mjaftueshme që nuk iu intereson kjo, prapë vazhdoni.

Kryesuesja – E përmendët vota të mjaftueshme, por anëtarëve të Kuvendit këtyre që po iu thua vota të mjaftueshme, iu ka sqarue dhe kanë pasë interes, kanë ardhë, kanë pritë edhe

drejtorin ku secilit në mënyrë individuale ia ka sqarue pse është kaq e veçantë për shpalljen e këtyre zonave.

Kryetari – Qëllimi i shpalljes së këtyre zonave me interes publik të veçantë z.Ajet, është bërë pikërisht sepse AKP-ja, i ka dhënë në shitje. Mendoj se si Komunë e Obiliqit, meqë është situatë e Obiliqit për shkak të pronave në mungesë, të paktën me shumicën që kemi diskutue edhe nga Ekzekutivi, qytetarët dhe asambleistët kemi ardhë në përfundim se është mirë të gjitha pronat që APK-ja, i jepë në shitje, të paktën mos me i lënë me i shitë, por me i ndalë eventualisht për nevojat e ndryshme komunale. Kjo është arsyeja.

Shaip Paloja – Mua, më duhet me bë një reagim sepse është hera e tretë, ose e katërt që z.Berisha, neve në njëfarë forme na nënçmon si anëtarë të Kuvendit ,gjëja se ne vetëm kemi numra, ne vetëm votojmë e nuk diskutojmë. Mirëpo, z.Ajet e din shumë mirë se ne jemi një ekip që kemi marrë pjesë në garën zgjedhore në krye me Kryetarin Gashi dhe qytetari na ka dhënë besimin. Prandaj, ne projektet dhe platformën e Kryetarit Gashi, programet ne jemi këtu për me i realizue në të mirën e qytetarit. Te zona me interes të veçantë, sidomos te zona, ish zona tregtare që është e shpallur vërtetë, nuk di se a ka më zonë me interes të veçantë se me eliminue atë zonë sepse ajo vetëm zonë tregtare nuk është, gjithçka tjetër është.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 1 votë kundër dhe 6 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Obiliq.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DPUKP-ja, për aprovimin e propozim vendimit me nr.1271 për shpallje me interes të përgjithshëm publik për objektet të cilat gjenden në parcelën kadastrale P-72614055-00631-24, në zonën kadastrale në Obiliq.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 1 votë kundër dhe 6 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për objektet të cilat gjenden në parcelën kadastrale P-72614055-00631-24, në zonën kadastrale në Obiliq.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Ministria e financave, për shfuqizimin e vendimit nr.-I-78, të dt.30.05.2022, për aprovimin e kërkesës së Klubit Aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit” për mbështetjen financiare të projekt propozimit për blerjen e pajisjeve për këtë klub për zhvillimin e sportit të paraglidingut si atraksion i ri në Komunën e Obiliqit.

Sami Ahmeti – Ne edhe atëherë kur i patëm miratuar këto lloj ndihmesash i patëm quajtur borxhet tuaja elektorale. Andaj, ju lutem që ti trajtoni pak më mirë drejtorët e drejtoreshat që kur të na sjellin dokumente të tilla për miratim ti lexojnë pak ligjet dhe Rregulloret sepse pastaj, po na kthehen si jo të ligjshme, e kjo po bën që ne, respektivisht ata asambleistë që votojnë si makina të konsiderohen si të padijshëm, apo të nënshtruar ndaj shefave të tyre. Ky klub, sa e di unë këtë vit ka marrë edhe një ndihmesë, apo subvencion nga Ekzekutivi dhe tendenca që ti jepet edhe nga Kuvendi është shumë e paligjshme. Kjo ka qenë arsyeja që unë disa herë kam biseduar me zyrtarë të MAPL-së, që është për keqardhje.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 5 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shfuqizimin e vendimit nr.-I-78, të dt.30.05.2022, për aprovimin e kërkesës së Klubit Aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit” për mbështetjen financiare të projekt propozimit për blerjen e pajisjeve për këtë klub për zhvillimin e sportit të paraglidingut si atraksion i ri në Komunën e Obiliqit.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se kryesuesi i Komitetit për komunitete ka dhënë dorëheqje dhe në vend të tij unanimisht është përzgjedhë z.Faton Beka. Po ashtu, me automatizëm z.Faton Beka do të jetë edhe anëtar në KKSB, por konkretisht ne duhet të marrim një vendim. Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota abstenim e aprovuan Vendimin me të cilin z. Faton Beka, zgjedhet kryesues i Komitetit për komunitete pas dorëheqjes së Avdyl Mustafës dhe njëherit i posa zgjedhuri do të jetë anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Kryesuesja – Drejtori është këtu, me ju dhënë përgjegje z.Ahmeti, për pyetjet që i keni bërë në KPF.

Sami Ahmeti – Mendoj se e kaluat një pikë të rendit të ditës sepse ka pasë edhe kërkesa për trajtim.

Kryesuesja - Kërkesat i kemi adresuar te Drejtoritë përkatëse, për shqyrtim dhe në Kuvend me ardhë me një rekomandim. Mirëpo, nuk kam marrë ndonjë përgjegje përveç drejtori i DSHPE-së, i cili siç duket ka një kërkesë.

Ajshe Haliti Pllana - Unë kam një kërkesë nga fshati Baimofc, do të thotë është në rrugën “Lahu” që lidhet me rrugën “Dituria” dhe “Mehmeti” është një deponi e grumbulluar e mbeturinave kuptohet aty nga banorët. Do të thotë kundërmon aromë shumë të rëndë dhe ata ju lusin që sa më shpejtë të ndërmerrni masa për largimin e kësaj deponie. Pyetja tjetër është pse në plan nuk janë të përfshira të gjitha fshatrat për grumbullimin e mbeturinave, sepse unë kam informata se edhe në fshatrat tjera ka këso deponish.

Valbonë Beka – Unë i kam 2 pyetje dhe pyetjen e parë e kam parashtrur edhe në seancën e kaluar për drejtorin e DPUKP-së, lidhur me çështjen e gjelbërimit se a po respektohen Rregulloret që janë 60 me 40 %. Pyetja e dytë është pse nuk po bëhet pagesa e mësimdhënësve, pagesa e mësimit për të rritur që po mbahet që 2 afate dhe tash po vjen afati i tretë, por pagesa nuk po bëhet për mësimdhënës, ku është problemi.

Abdyrrahman Krasniqi – Përgjegjet se sa i përket mini deponisë që e potencoi zonja nuk kemi informata, por do të shohim dhe do të marrim masa në këtë drejtim bashkarisht me kompaninë “Pastrimi”. Ndërsa sa i përket shtrirjes së rrethit dhe mbledhjes së mbeturinave, unë mund të flas me përgjegjësi të plotë si drejtor edhe si aksionar, por e kemi edhe drejtorin e kompanisë “Pastrimi” këtu, që jemi një ndër Komunitat më të përfshira me rrejtin e mbledhjes së mbeturinave.

Kryesuesja – Po ashtu, në KPF, drejtor ishte edhe çështja e shtëpizave në sheshin “Dëshmorët e kombit”.

Abdyrrahman Krasniqi – Sa i përket çështjes së shtëpizave në sheshin “Dëshmorët e kombit” dhe në sheshin “Adem Preniqi” ne e kemi bërë shpalljen dhe ka pasë 2 aplikues. Ne jemi në përpilim të kontratave dhe besoj se gjatë këtij muaji do të nënshkruhen kontratat ndërsa, për pjesën tjetër do të bëjmë edhe një shpallje dhe në momentin që do të ketë aplikues, ne do ti funksionalizojmë.

Sami Ahmeti - Në fakt në përgjegjen e drejtorit unë vetëm e kisha shtue pyetjen se a janë bërë parallogaritë, ose njëfarë planifikimi se për çka do të vendosen ato shtëpiza, sa i kushtojnë Komunës dhe cili është profiti i Komunës, kur dihet se ato po shfrytëzohen për lodra momentalisht. Sido që të jetë në seancën e kaluar njëri prej drejtorëve na ka premtuar se në këtë seancë do të na jepë përgjegjet që i kemi bërë në seancën e kaluar. Besoj se i thirrni kujtesës dhe na përgjegjeni në pyetjet që i kemi bërë.

Abdyrrahman Krasniqi - Përgjegjet se shtëpizat janë planifikue për festat e fundvitit dhe ne i kemi pajisë edhe me energji elektrike dhe besoj se prej muajit tetor e nëntor, do të funksionalizohen për shërbime të ndryshme si të gastronomisë, kemi kërkesa edhe për shitjen e produkteve të bletarisë, mjaltës e gjësende të ndryshme. Mirëpo, kryesisht janë mendue si projekt për dekorimin dhe funksionalizimin e sheshit për fundvit sikurse në gjithë botën që për fundvit dekorohet shteti, bëhen njëkohësisht edhe këto shtëpizat me ushqime tradicionale me verëra të ndryshme, e kafe për me zbukurua sa më shumë qytetin.

Unë fatkeqësisht nuk kam qenë në KPF, për shkak të angazhimeve, por e kemi edhe një pyetje lidhur me parkingun përballë Vivës te sheshi “Adem Preniqi”. Ne kemi veprue në bazë të Rregullores dhe kemi krijuar hapësirë për taksitë në atë zonë, kemi dhënë 8 parkingje, ndërsa pjesa tjetër është parking i lirë për qytetarët. Do të thotë ne nuk kemi ndërmarrë kurgjë diçka në atë drejtim, pjesa e parkingur për taksitë është edhe me shenjat horizontale, por edhe me shenjat vertikale, ndërsa pjesa tjetër është parking i lirë për atë pjesë.

Valon Svirca - Pyes për taksitë a është vetëm për një kompani, apo edhe për taksitë tjerë, që janë privat sepse aty unë kam parë vetëm taksitë “Ardi” ndërsa, të tjerët nuk mund të parkohen sa e di unë dhe kështu i kemi ankesat prej taksive tjerë.

Abdyrrahman Krasniqi - Përgjegjet se unë i kam takuar taksitë individual 3 herë para se me dhënë pëlqimin aty dhe na kanë kërkuar që pëlqimin me iu dhënë si grup. Taksitë individual i kanë 3 parkingje, ndërsa kompania “Ardi” i ka 5 parkingje. Lejimi për parking në atë zonë është bazuar në Rregulloren e shërbimeve publike, por a duhet me shkue me u arkue aty, ajo edhe është vullnet i tyre.

Mbledhja përfundoi në ora 10:47’

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

